



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 09
Prishtinë, më 24.04.2012, në orën 10.00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Biserka Kostiq, Albana Gashi dhe Kimete Bytyçi.

Munguan: Justina Pula, Kymete Bajraktari dhe Duda Balje.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Të ftuar: Alan Robinson -EULEX-DFM; Arsim Gërxheliu-Departamenti i Mjekësisë Ligjore; Kushtrim Gara-ZKM-KQPZK.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi dhe Florijana Shala –OSBE; Elizabeta Gjidoda, Shkumbin Beqiri-KDI; Uke Gashi-ZPRK; Pleurat Kurti-EUSR; Nuredin Ibishi- CDF dhe Burim Tahiri- praktikant.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1 Miratimi i rendit të ditës;

2. Miratimi procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 28 mars dhe 3 prill 2012;
3. Takim me përfaqësuesit e Zyrës së Mjekësisë Ligjore, EULEX-it dhe Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur lidhur me shqyrtimin e pikës 74 të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, që ka të bëjë me mbetjet mortore të paidentifikuara në morgun e Prishtinës;
4. Shqyrtimi i peticionit të Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime, por fillimisht u diskutua për pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Takim me përfaqësuesit e Zyrës së Mjekësisë Ligjore, EULEX-it dhe Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur, lidhur me shqyrtimin e pikës 74 të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, që ka të bëjë me mbetjet mortore të paidentifikuara në morgun e Prishtinës

Kryetarja- Fillimisht i njoftoi të pranishmit, duke theksuar se Komisioni vepron në bazë të planit të punës dhe Planit të Veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i hartuar në bazë të Raportit të Progresit dhe një ndër pikat që duhet të realizojë është edhe pika 74 e këtij plani ku thotë: “Mbetjet mortore të paidentifikuara e të ruajtura në morgun e Prishtinës, vazhdojnë të jenë shkak për brengosje. Mungesa e një marrëveshjeje formale mes Kosovës dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë është pengesë ndaj qartësimi të pohimeve në lidhje me mbetjet mortore në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë”. Ne kemi paraparë takim me përfaqësues të Zyrës së Mjekësisë Ligjore dhe Komisionin Qeveritar për Persona të Pagjetur. Gjithashtu, kërkohet një raport nga Ministria e Punëve të Jashtme lidhur me mungesën e një marrëveshjeje formale mes Kosovës dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, e cila është pengesë ndaj qartësimi të pohimeve në lidhje me mbetjet mortore në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Ajo tha se marrjen e këtyre informatave të sakta mendojmë që t'i realizojmë nga ju (EULEX-i) dhe fjalën ia dha përfaqësuesit të EULEX-it.

Alan Robinson (EULEX) -Falënderoi Komisionin për ftesën për të marrë pjesë në këtë mbledhje dhe tha se para ca kohe, EULEX-i e ka kryer raportin vjetor të punës, lidhur me personat e pagjetur dhe tha se tani e ka kuptuar se Komisioni nuk e paska marrë atë raport dhe premtoi se shumë shpejt ky raport do të jetë në duart e anëtarëve të Komisionit. Sa i përket raportit, ai tha se ky raport është shumë i rëndësishëm, i cili paraqet shumë çështje me të cilat ballafaqohet mjekësia ligjore dhe po punojmë së bashku me Departamentin e Mjekësisë Ligjore të Ministrisë së Drejtësisë.

Sa i përket pikës 74 të Planit të veprimit, që ka të bëjë me mbetjet mortore në morgun e Prishtinës, në media jepet gabimisht se në morgun e Prishtinës gjenden 400 trupa të paidentifikuar. Dua të them se situata është krejtësisht ndryshe. Mund të flasim për 250

trupa dhe 101 pjesë të trupave dhe hulumtimet tona tregojnë se këto 101 pjesë kanë qenë të personave të identifikuar menjëherë pas lufte. Dihet se menjëherë pas lufte trupat nuk janë gjetur të tërësishëm dhe këto pjesë ju takojnë personave që janë varrosur pas luftës, ndërsa për këto mbetje nuk ka paraqitje se janë persona të zhdukur.

Sa i përket 250 trupave që janë në morg, bëhet fjalë për dy grupe: grupi i parë është persona të moshuar dhe grupi i dytë janë të rinj dhe me moshë mesatare dhe kryesisht janë meshkuj. Është me rëndësi të theksohet se secili prej këtyre trupave e ka kaluar procesin e ADN-së, por nuk kemi përputhje të gjakut të këtyre mbetjeve mortore me asnjë të afërt të tyre.

Unë nuk besoj se do të zgjidhet problemi i identifikimit të të gjithë këtyre 250 trupave. Vlen të theksohet se shumë trupa janë zhvarrosur nga Tribunali i Hagës, menjëherë pas luftës, dhe shumë trupa në morg, nuk kanë vdekur si pasojë e luftës dhe konkluzioni është se askush nuk i ka paraqitur si të zhdukur.

Kryetarja- Duke u ndërlidhur me parafolësin, tha se këtu po flasim për 250 trupa. Nëse këta trupa janë gjetur në mënyrë grupore, atëherë nuk mund të themi se kanë vdekur në mënyrë natyrore, sepse gropimet janë bërë në varreza masive dhe prej analizave mund të dihen vitet se kur kanë vdekur ata, gjatë luftës apo shumë më herët. Ju lutem, nëse ka mundësi të jepen sqarime rreth kësaj çështjeje.

Alan Robinson (EULEX) - Tha se trupat që gjenden në morgun e Prishtinës, nuk e paraqesin vetëm një ngjarje, nuk mund t'ju them numrin e ngjarjeve të këtyre rasteve për momentin, sepse as nuk më kujtohen tani, por mund të flas për 80 ngjarje të ndryshme në tërë Kosovën, pra trupat që gjenden në morg ju takojnë këtyre ngjarjeve.

Kryetarja-Ne kemi nevojë për këto informacione.

Pyeti: A dihet sa është numri i tërësishëm i personave të pagjetur, sepse gjithnjë po manipulohet me numra?

Alan Robinson (EULEX) - Numri i saktë i personave të zhdukur, duke iu referuar prillit të vitit 2012, është 1781 persona të zhdukur. Ky numër mund të jetë edhe më i ulët, sepse që nga ky raportim janë paraqitur edhe 12 kërkesa të reja për personat që kanë qenë të pagjetur, d.m.th. lista e personave të pagjetur është listë dinamike, d.m.th. lista gjithmonë ndryshon.

Kimete Bytyçi- Bëri pyetje: Sa është numri i atyre personave që ju po e quani vdekje natyrore, e që janë paraqitur si persona të zhdukur?

Alan Robinson (EULEX) - Nuk është e lehtë të jepet vlerësimi sesi ka ndodhur, por kjo që ne nuk kemi mundur të identifikojmë 250 trupa, jep një indikacion se paku që disa prej tyre nuk kanë qenë asnjëherë të paraqitur si të zhdukur, ndërsa për të vërtetuar se një person është i zhdukur, kërkohen disa veprime nga pikëpamja e mjekësisë ligjore, këto që do t'i përmend janë më të rëndësishme. Duhet t'i intervistojmë familjet që i kanë të dhënat mbi familjarët e tyre të zhdukur, dhe ne duhet që prej tyre të kërkojmë së paku dy mostra të gjakut, do të thotë të anëtarëve të familjes së tyre, kështu që kur të dëgjojmë për ndonjë raportim të ri për personin e zhdukur, Njësia për kontakte me familjarë dhe

ekipi i forenzikës i EULEX-it, do të bëjë përpjekje që të ballafaqohet në mënyrë sa më të mirë me familjarët e personit të zhdukur, dhe më e rëndësishmja është të kërkojnë gjak për të konstatuar përputhjen e ADN-së dhe pastaj bëhen krahasimet nga tabelat.

Biserka Kostiq- Kam një pyetje lidhur me anëtarët e familjeve, të cilët e kanë shumë vështirë të japin gjakun. Me një paraqitje publike, njerëzit do të ofroheshin për të dhënë gjakun. Mua më intereson të dijë se a jeni ju të kënaqur me rezultatet e juaja që për dy vite keni identifikuar vetëm 35 trupa, ne e dimë që identifikimi është proces shumë i ndërlikuar, por më intereson mos ndoshta ekziston ndonjë arsye e tretë që mos të vijë deri te identifikimi i personave.

Alan Robinson (EULEX) - Nuk është e lehtë të bëhet mbledhja e mostrave të gjakut, pasi që shumë njerëz kanë lëshuar Kosovën. Partneri ynë, ICMP-ja, ka bërë përpjekje shumë të mëdha për të shkuar edhe në SHBA, Rusi, Gjermani, Zvicër etj. dhe kjo nuk mund të zgjidhet për një ditë, dhe e dyta ka, raste shumë tragjike ku e tërë familja, çdo individ i një familje është vrarë. Jemi përpjekur që ta zgjidhim këtë çështje, duke e bërë pemën e familjeve, duke u munduar që të gjejmë se ky është i atij. E dini sesi shkon ajo procedurë, kemi bërë zhvarrimin e pjesëve të eshtrave nga ai trung familjar, trashanik të gjyshit, që në bazë të ashtpërputhjes ta identifikojmë personin, pra në vend të gjakut, mund të marrim pjesën e ashtit të një personi të zhdukur, ndërsa në bazë të krahasimeve të ADN-së të të dy eshtrave, mund të bëhet identifikimi. Sa i përket pyetjes për shkakun e tretë, nëse ekziston, pra që mos të bëhet identifikimi i këtyre personave, unë nuk e di që ekziston ai shkak i tretë dhe nuk kam përgjigje për këtë.

Biserka Kostiq- Bëri pyetje: A jeni të kënaqur me rezultatin njëvjeçar të punës, a është bërë identifikimi i 35 rasteve?

Alan Robinson (EULEX) –Ne nuk përmendem se 35 persona janë identifikuar në vit. Unë thashë se i kemi identifikuar 35 persona të rinj nga kontejnerët që i kemi në morgun e Prishtinës, ndërsa në tri vitet e fundit ju kemi dorëzuar familjarëve gati mbi 300 trupa të identifikuar dhe nga këta 300 trupa, përafërsisht 220 trupa kanë qenë në listën e personave të zhdukur.

Rita Hajzeraj- Lidhur me këtë, tha se problemi kryesor tek ne është edhe gjetja e 1781 trupave për të cilët ne konsiderojmë se nuk gjenden në territorin e Kosovës, pasi që në shumë vende, veç janë bërë hulumtimet. Çfarë keni ndërmarrë ju në territorin e Serbisë, pasi që supozohet se janë bartur trupat në Serbi dhe konsiderohet se atje ka varreza masive?

Alan Robinson (EULEX) - Tha se në vitin e kaluar kemi dërguar ekipin e EULEX-it si vëzhgues në punët që kryheshin në Rashkë, Rudnicë të Rashkës dhe kjo ka ndodhur dy herë. EULEX-i nuk ka qenë i kënaqur me metodat e përdorura atje për ta vlerësuar terrenin. Atje ndodhet një ndërtesë, e cila duhet të rrënohet dhe autoritetet duhet të ndërhyjnë nën të për t'u bërë hulumtimet.

Kryetarja -Duke u ndërlidhur me këtë, bëri pyetje: Me sa u shpjegua, a do te thotë se objekti është ndërtuar mbi varreza?

Alan Robinson (EULEX) - Nuk do të thotë se patjetër është ashtu, por ai terren duhet të hulumtohet patjetër, dhe sa i përket kësaj për ta shtyrë këtë proces, i kam shkruar një letër kryetarit të Komisionit Qeveritar në Serbi, duke i shprehur brengat tona profesionale lidhur me mënyrën se si është bërë vlerësimi i asaj vendndodhje, ky objekt i Rashkës është pika më prioritare e jona.

Albana Gashi- Më intereson të di se a ka kthyer përgjigje kryetari i Komisionit Qeveritar të Serbisë dhe çfarë është përgjigjur?

Alan Robinson (EULEX) – Duke u përgjigjur në pyetjen e deputetes Albana Gashi, tha se përgjigje zyrtare nuk kemi, por më duhet t’ju njoftoj se ekspertët tanë kanë qenë në liqenin e Peruqas, në kufirin Serbi - Bosnje, dhe siç e dimë, në vitin 2000 është gjetur kontejneri me trupa të shqiptarëve, i cili ka qenë i hedhur në liqen.

Rita Hajzeraj- Sa i përket rastit të Rashkës, ju keni shkuar atje pasi që EULEX-i është njoftuar nga dikush se atje ka varrezë masive apo si shkua ju atje?

Pasi që Komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur në Serbi nuk ju ka kthyer juve përgjigje, a mendoni se duhet të ndërrohet strategjia pak dhe se EULEX-i duhet të jetë më aktiv dhe të bëjë presion që vetë shteti i Serbisë të marrë iniciativë për t’i gjetur këto varreza masive, në bashkëpunim me EULEX-in, sepse po shihet që nuk ka pasur rezultate.

Alan Robinson (EULEX) - Rasti i Rashkës ka filluar shumë vite më parë.

Ka indikacione që persona të zhdukur ka jo vetëm në Serbi, por ka edhe në Maqedoni, Mal të Zi dhe në Shqipëri, por sidoqoftë shumica e personave të zhdukur që i kemi gjetur deri më tani kanë qenë në Kosovë. Çështja e këtyre varrezave masive është më shumë çështje politike sesa humanitare.

Kurtan Kajtazi- Thuhet se edhe jashtë Kosovës në disa shtete ka mbetje mortore edhe Raporti i Progresit e thekson mungesën e marrëveshjes midis Kosovës dhe Maqedonisë, për t’i identifikuar mbetjet mortore që ekzistojnë atje. Nuk dimë deri ku kanë arritur procedurat në këtë drejtim, por ju si EULEX, çka keni ndërmarrë në këtë drejtim për t’i identifikuar ato mbetje?

Alan Robinson (EULEX) – Më duhet t’ju njoftoj se në vitin 2010 e kemi pasur një veprim shumë të fuqishëm lidhur me vendndodhjen e Antrijovica në Mal të Zi. Në bashkëpunim me autoritetet e Malit të Zi, kemi kryer një vlerësim dhe veprim i cili në fund ka dalë si negativ. I përmenda rastet e Serbisë, ndërsa sa i përket Maqedonisë iu kemi dërguar disa shkresa partnerëve tanë atje, duke kërkuar leje që të na lejojnë të shkojmë në vendet e supozuara dhe vetëm të shikojmë dhe ka qenë një hap shumë i mirë dhe i rëndësishëm. Mirëpo, për fat të keq, në atë kohë pati ndodhur një incident në mes kufirit të Maqedonisë dhe Kosovës dhe ishte kërkuar nga ne, si përfaqësues të EULEX-it që atë çështje ta ndalim për momentin, derisa të vinin momente më të përshtatshme.

Kurtan Kajtazi- Pyeti: Çka është ndërmarrë kohëve të fundit për këtë çështje, d.m.th. prej vitit 2011 e këndej?

Biserka Kostiq- Pyeti: A keni të dhëna statistikore lidhur me identifikimin e të pagjeturve të komuniteteve, meqë mungojnë të dhënat sipas kësaj liste?

Ajo kërkoi sqarime lidhur me numrin e të zhdukurve nga komunitetet, meqë kjo nuk është sekrete.

Alan Robinson (EULEX) - Duke ju përgjigjur pyetjes, tha se të gjitha ato të dhëna që juve ju interesojnë janë të publikuara në raportin vjetor dhe këto të dhëna mund t'i gjeni në këtë raport.

Kryetarja- Falënderoi përfaqësuesin e **EULEX-it** për këto informata, sepse kjo është një plagë e pashëruar. Më pas, fjalën ia dha z. Arsim Gërxhaliu nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore.

Arsim Gërxhaliu- Janë disa problematika, të cilat ekzistojnë, po përmendim Rashkën. Edhe pse kemi një zotim qysh nga viti 2003 se komisionet duhet të bashkëpunojnë ndërmjet veti, në kuadër të ombrellës humanitare, por çdo kontakt me Serbinë është politik. Kërkesat tona gjithmonë nuk kanë hasur në ndonjë mirëkuptim me palën serbe, pasi që pala serbe i di këto gjëra, por ata i fshehin për të vepruar në kohën dhe momentin e duhur si akt politik. Problemet janë më të thella sesa që i mendoni, sepse kemi të bëjmë me disa grupime dhe se këto janë mbi 2000 persona që janë varrosur pa kurrfarë analize, pa bërë ADN-në, pa ditur se cili person i takon cilës familje. Gjithashtu, ne kemi edhe një grup të familjeve që nuk japin gjak për analiza, sepse ende besojnë se familjarët e tyre janë të gjallë diku në Serbi. Kemi edhe një grup të njerëzve të cilët nuk i marrin familjarët e tyre edhe pse janë identifikuar, sepse edhe ata besojnë se janë të gjallë.

Kemi edhe problemin ku njerëzit janë zhvarrosur disa herë dhe problemin se personi është varrosur, por ka disa mbetje kockore që janë në morg dhe janë pjesë të atyre trupave që janë të varrosur dhe familjarët e dine këtë gjë, por nuk duan t'i marrin, sepse thonë se nuk duan të trazohen dhe të shqetësohen edhe njëherë.

Ne kemi menduar që të bëhet një memorial i përbashkët dhe të vendosen emrat e të gjithëve, në shenjë respekti dhe vend ku do të vizitohet, por ndoshta edhe në ndërkohë teknologjia do të ishte avancuar dhe pas një kohe do të ishte e mundur të bëhet identifikimi i të gjithëve, sepse për shumicën kemi mostrat e gjakut.

Kemi rastin në Shqipëri, mbrapa kufirit ku në varrezat civile ekzistojnë varre ku shkruhen të dhëna vetëm për gjininë ku shkruan se është trup mashkulli, bëhet fjalë për raste ku janë vrarë në Kosovë dhe janë bartur përmes liqenit dhe janë varrosur aty, por kontaktet janë shumë të vështira përmes hierarkisë.

Problemet janë shumë të mëdha dhe ballafaqohemi me lloje të ndryshme të rasteve dhe kemi nevojë për mbështetje shumë më të madhe nga institucionet.

Kryetarja- Bëri pyetje sa i përket buxhetit të Departamentit të Mjekësisë Ligjore se a është në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Arsim Gërxhaliu- Departamenti i Mjekësisë Ligjore funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe e ka buxhetin nga Ministria e Drejtësisë, por ligjet dhe forma e tenderëve, në të shumtën e rasteve, na bllokojnë dhe na vonojnë në kryerjen e punëve tona.

Kimete Bytyçi- U përmend më herët Batajnica, më intereson të di se a ka përfunduar çështja e Batajnicës dhe Petrovosellës?

Alan Robinson (EULEX) - Batajnica është çështje komplekse dhe është rast i papërfunduar dhe para se ta përmbyllim këtë rast, duhet të kryhet edhe një gërmim në poligonin e gjuetisë në Prizren, sepse kemi indikacione se çdo gjë që ka lidhje me Batajnicën, ka lidhje edhe me këtë vend në Prizren, por për fat të keq, nuk kemi makina për gërmim dhe për këtë kemi problem që këtë rast ta mbyllim në tërësi, pra i ashtuquajtur i Batajnicës.

Sa i përket Petrovosellës, do t'ua jap përgjigjen me shkrim, sepse për momentin nuk i kam të dhënat, mund t'ua jap këtë të dhënë se jemi duke i pritur rezultatet e ADN-së që në shumicën e rasteve kanë të bëjnë me bashkimin e eshtrave, d.m.th. u përkasin personave që janë varrosur më parë.

Kimete Bytyçi- Kemi rastin e Berishajve të Suharekës ku i kanë gjuajtur në lumë dhe i kanë futur nëpër frigoriferë dhe pastaj i kanë dërguar në Serbi.

Arsim Gërxhaliu-Duke folur për Peruqa ku është gjetur kontejneri, tha se ai kontejner njëherë ka notuar përmbi ujë dhe i janë hapur dyert dhe në ujë kanë notuar disa persona, pastaj kanë ardhur disa njerëz prej qytetit të afërt dhe aty i kanë lidhur me blloka dhe i kanë hedhur në ujë. Është kontrolluar me zhytës, është gjetur pjesa e kamionit dhe kaq ka qenë. Është shumë e qartë kjo çështje, disa trupa s'kanë për t'u gjetur kurrë, e aq më tepër që kemi informacione që kanë ndodhur disa djegie. Megjithatë, krahasuar me vendet tjera, në këtë drejtim jemi shumë më mirë, në krahasim me Bosnjën.

Sa i përket identifikimit të personave, jemi në një situatë të vështirë, sepse për disa raste nuk kemi mundur t'u japim përgjigje.

Shadije Kasumi- Këshilli koordinues për persona të zhdukur

Rasti i paraqitur për 55 trupa të cilët janë gjetur në Mitrovicë, për të cilin unë e kam një lutje nga familjarët, sepse ata po dyshojnë se në mesin e trupave janë edhe të luftës së fundit dhe janë familjarët e tyre ata që luten që të bëni diçka për këtë rast, të ndërmerret ndonjë hap për identifikim.

Arsim Gërxhaliu- Momentin që marrë një raport të ekspertëve dhe mua më shkruhet një letër prej ekspertëve se nuk i takojnë luftës së fundit.

Familjarët dhe dëshirat e tyre janë diçka tjetër, ndërsa realiteti është tjetër gjë. Ne nuk bazohemi në fjalë të pabaza. Nuk kishte qenë shumë problem ky rast, por çka ndodh në te ardhmen nëse i kthehemi edhe njëherë Luftës së Dytë Botërore e Luftës së Parë Botërore.

Kryetarja- Për këto informacione shumë të rëndësishme falënderoj shumë të pranishmit dhe ne do t'ju ftojme prapë në takim për hapat që do t'i ndërmarrim në të ardhmen.

2. Miratimi procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 28 mars dhe 3 prill 2012

Biserka Kostiq- Bëri vërejtje në procesverbalin e dt. 3 prill 2012 dhe tha se pyetja e bërë për Zëvendësavokatin e Popullit i është përfshirë pjesërisht dhe se mungon përgjigjja e tij, edhe pse nuk i është përgjigjur në mënyrë të plotë, por mungon përgjigjja në procesverbal.

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e datës 28 mars 2012, ndërsa procesverbali i datës 3 prill 2012, u miratua me vërejtjen e anëtares së Komisionit, Biserka Kostiq.

4. Shqyrtimi i petitionit të Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës

Komisioni, pas një debati konstruktiv lidhur me petitionin, nxori këtë

P ë r f u n d i m

Peticioni i nënshkruar nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, në parim i plotëson kushtet formulo-juridike, por nuk bie në fushëveprimtarinë e tij, prandaj i njëjti i procedohet për shqyrtim Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

I rekomandojmë Komisionit kompetent që ta shqyrtojë këtë petition dhe të shikojë mundësinë e marrjes së nismës për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për vlerat e luftës, pra që të përfshihet kjo kategori me ligj.

Gjithashtu, kjo kategori e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, derisa të miratohet ligji i lartpërmendur, të përfshihen në skemën e ndihmës sociale në kuadër të MPMS.

5. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës, nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali

